



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**

**PROÇES VERBAL**

**MBI VERIFIKIMIN E DOKUMENTACIONIT TË PARAQITUR NGA APLIKANTËT  
PËR VENDET VAKANTE TË SHPALLURA NË DATËN 23.12.2025 NË FAQEN  
ZYRTARE TË AMVV**

Bazuar në rregulloren e brendshme të AMVV, neni 14 pika 14/7/a për procedurat e pranimit në punë , si dhe në manualin për “Përcaktimin e rregullave, kriterëve dhe procedurave për shpalljen vendeve vakante në administratën e AMVV-së”, mbahet ky proces verbal sot, datë 07.12.2025 nga komisioni i ngritur me urdhër nr.88, datë 08.12.2025, protokolluar me nr. 761/1.prot, për procedurat e pranimit në pozicionin vakant, dhe për të verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët në zyrën e protokollit të AMVV-së, për pozicionet të shpallur në faqen zyrtare më 23.12.2025.

**I. DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM DHE SHQYRTIMI NGA KOMISIONI**

Punëmarrësi është i detyruar t'i paraqesë Punëdhënësit dokumentet e mëposhtme:

- a) dokumentin e identitetit, ( fotokopje);
- b) curriculum vitae,(CV);
- c) librezën e punës;
- d) dëshmi penaliteti;
- e) kërkesë e motivuar;
- f) fotokopje të noterizuar të diplomës.

Komisioni pasi bëri verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga aplikantët dhe verifikoi kërkesat e mëposhtme:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore, që nuk është shuar sipas këtij ligji;

- Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës;
- Të zotëroj gjuhën Angleze të folur dhe të shkruar.

## II. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Komisioni njofton për vazhdimin e konkurrimit në fazën e dytë të intervistimit të kandidatëve me gojë.

Për vendin vakant **“Përgjegjës” në Sektorin e Performancës, në Drejtorinë e Statistikës dhe Performancës, 1 pozicion.** Klasa e pages III-2, kanë paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar pranë protokollit të institucionit aplikantët:

1. **Z. Etis Jareci;**
2. **Znj. Keti Flamuraj;**
3. **Z. Vilson Blloshmi.**

Për vendin vakant **“Specialist” në Sektorin e Performancës, në Drejtorinë e Statistikës dhe Performancës, 1 pozicion.** Klasa e pages IV-2, kanë paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar pranë protokollit të institucionit aplikantët:

1. **Znj. Aida Myftaraj;**
2. **Znj. Megi Spahiu;**
3. **Znj. Paola Mallkas;**
4. **Z. Redi Kola;**
5. **Znj. Sara Andoni;**
6. **Z. Vilson Blloshmi.**

## III. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

1. Vendimi nr 227 datë 9.4.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”  
([Vendimi-227-date-9.4.2024-Per-organizimin-dhe-funksionimin-e-agjencise-per-mbeshtetjen-e-veteqeverisjes-vendor.pdf](#));
2. Ligji nr 139 date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (<https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/Ligji-nr.-139-date-17.12.2015-Per-veteqeverisjen-vendore.pdf>);
3. Rregullore e Brendshme e AMVV  
(<https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2025/06/rregullorja-e-re-AMVV-17.06.2025.pdf>);
4. Raporti vjetor i AMVV, 2024

([https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2025/03/Raporti-vjetor\\_AMVV\\_-2024\\_FINAL-1-1.pdf](https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2025/03/Raporti-vjetor_AMVV_-2024_FINAL-1-1.pdf));

5. Njohuri mbi detyrat e sektorit të performancës:

- a. Raporti vjetor i Sistemit të Matjes së Performancës  
(<https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2025/11/SMP-2024.pdf>),
- b. Metodologjia e SMP (<https://qeverisjavendore.gov.al/perfomanca-dhe-qeverisja-e-mire/raporte/smp-2025/>)
- c. Udhëzimi i Përbashkët nr 01 datë 11.07.2025  
(<https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2025/07/Udhezim-i-perbashket-MF-MSHPV-granti-i-performances.pdf>)
- d. Mekanizmi i Grantit bazuar në Performancë  
<https://qeverisjavendore.gov.al/perfomanca-dhe-qeverisja-e-mire/granti-i-bazuar-ne-performance/rreth-grantit/>).

#### IV. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **50 pikë**.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a) Njohuritë mbi fushën e njohurive, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **50 pikë**.

#### V. NJOFTIMI I INTERVISTËS ME GOJË

**Intervista do të zhvillohet ditën e hënë, datë 12.01.2026 në adresën; Rruga “Mustafa Matohiti”, Godina nr 4, përbi Shkollës 9-vjecare “Kosova”, Tiranë.**

**Për pozicionin vakant “Përgjegjës” do të zhvillohet intervista në ora 10:00.**

**Për pozicionin vakant “Specialist” do të zhvillohet intervista në ora 13:00.**

Aplikantët do të njoftohen me email në adresat e tyre të dorëzuara.